VENDIM
Nr. 39, datë 7.3.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "KASTRATI ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "ç" dhe nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d", nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë "Kastrati Energy" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Kastrati Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 111 prot., datë 1.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 21, datë 19.2.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Kastrati Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Pas kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 32/5 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe mbas përfundimit të afatit, rezultoi se nuk ka pasur komente nga palë të interesuara.
- ERE, me shkresën nr. 111/1 prot., datë 19.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, si dhe bëri me dije për mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.
- Shoqëria "Kastrati Energy" sh.p.k., me shkresën nr. 111/2, datë 20.2.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.
- Aplikimi i shoqërisë "Kastrati Energy" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f", pika 4.7.1, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Kastrati Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi